

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6389
E martë, 17 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Rama: Nga 1 gushti rreth 860 mijë turistë e vizituan Shqipërinë IFAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA PRANUAR APLIKIMET E SUBJEKTEVE POLITIKE PËR ZGJEDHJET LOKALE TË 17 TETORIT IFAQE 4-5

PARTITË POLITIKE DORËZOJNË LISTAT E KANDIDATËVE PËR ZGJEDHJET LOKALE



Subjektet politike kanë dorëzuar të hënën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) listat e kandidatëve për kryetarë të komunave dhe të kandidatëve për asamble

komunale. Listat e partive të mëdha nuk kanë sjellë ndonjë befasi, duke zyrtarizuar kandidatët që janë pritur. Edhe këtë herë është vërejtur numër i vogël i

kandidateve në garën për kryetarë të komunave. Përfaqësuesit e partive më të mëdha politike kanë shprehur optimizëm për rezultatin e zgjedhjeve të 17 tetorit

OPINION

STATUS QUO TË JANË TË PAQËNDRUESHME F. 3

Shkruan:
Valon MURATI



AKTUALE

POLICIA ZBATON PLANIN OPERATIV "ALKOOLI", KONFISKON 216 PATENTSHOFERË F. 7

EKREM KASTRATI, KANDIDAT I NISMËS PËR KRYETAR TË MALISHEVËS F. 6

EKONOMI



OEK-u DHE PLATFORMA "CIVIKOS", ME REKOMANDIME TË PËRBASHKËTA PËR VAKSINIM MASIV F. 8

ZVICRA, FUQINË PUNËTORE MË TË AFTË NË BOTË F. 8

SPORT



PRISHTINA KONFIRMON NNDARJEN EDHE ME PESË FUTBOLLISTË F. 12

Ende s'ka hollësi rreth strehimit të afganëve IFAQE 7



Dy të vdekur nga Covidi dhe 740 raste pozitive në 24 orët e fundit IFAQE 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepgjisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ende s'ka hollësi rreth strehimit të afganëve

KABUL, 16 GUSHT - Autoritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë duke komunikuar me autoritetet e Kosovës lidhur me mundësinë që institucionet e saj të strehojnë një numër të personave nga Afganistani, pas marrjes së kontrollit në këtë vend nga talebanët. Këtë lajm e ka konfirmuar për "Radio Evropë e Lirë" një zëdhënës i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë. "Ne mund të konfirmojmë se qeveria amerikane është në bisedime me Qeverinë e Kosovës lidhur me atë se si Kosova mund të ndihmojë partnerët amerikanë në Afganistan. Tash për tash nuk mund t'ju japim më shumë hollësi", thuhet në përgjigjen me shkrim që zëdhënësi i Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë ia ka dhënë "Radios Evropë e Lirë".

Kosova do t'i strehojë afganët "pa hezitim"

Institucionet në Kosovë janë shprehur të gatshme t'i strehojnë qytetarët afganë pas komunikimit që ata thonë se kanë pasur me autoritetet amerikane. Të dielën, më 15 gusht, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se më 16 korrik është kontaktuar nga ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, i cili ia ka përcjellë kërkesën e presidentit Joe Biden, që Kosova t'i strehojë përkohësisht civilët afganë, kërkesë të cilën ajo ka thënë se e ka pranuar "pa asnjë hezitim". Ajo ka treguar se "Kosova e respekton të drejtën ndërkombëtare dhe obligimin që rrjedh nga ajo për mos t'ua mbyllur derën refugjatëve".

Presidentja Osmani ka thënë se Qeveria e Kosovës ka formuar një grup punues që do të merret me çështjen organizative, në bashkëpunim me partnerët amerikanë.

Qeveria e Kosovës, po ashtu, ka konfirmuar se sa i përket strehimit të afganëve, kanë bashkëpunuar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në një përgjigje dhënë "Radios Evropë e Lirë", Luan Dalipi, shef i



stafit të kryeministrit të Kosovës, ka thënë se "gjithçka do të përmbyllet mirë". "Ka shumë punë logjistike e teknike, të sigurisë dhe sociale, që po i trajtojmë me kujdes. ShBA-ja është aleatja jonë kryesore dhe partnerja jonë strategjike", ka thënë Dalipi.

Institucionet, pa përgjigje për përgatitjet

"Radio Evropë e Lirë" më 16 gusht u ka shkruar zyrtarëve të kabinetit të presidentes Vjosa Osmani, por edhe zyrtarëve të Zyrës së kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për të mësuar për më të rejtat lidhur me procesin e krijimit të mundësive për strehimin e qytetarëve afganë, por ata nuk kanë dhënë përgjigje. "REL" i është drejtuar Qendrës për Azil, për të mësuar nëse kanë nisur përgatitjet eventuale për pranimin e qytetarëve afganë, si dhe për kapacitetet e mundshme të strehimit. Por, drejtuesit e kësaj qendre kanë thënë se të gjitha pyetjet lidhur me këtë çështje duhet bërë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Qeverisë së Kosovës.

Zyrtarë të kabinetit të ministrit të Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, të cilët janë kontaktuar nga "Radio Evropë e Lirë", kanë theksuar se së shpejti ministri Sveçla do të mbajë një konferencë për media, për t'iu përgjigjur pyetjeve të shumta lidhur me çështjen e strehimit të një numri të qytetarëve afganë. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) ka thënë se është duke vazhduar

angazhimin intensiv për të identifikuar dhe ndihmuar shtetasit e Kosovës që ndodhen në Afganistan me qëllim të largimit sa më të shpejtë nga atje. "Deri në mesditën e së hënës MPJD është në kontakt të drejtpërdrejtë me tre shtetas dhe po angazhohet t'u dalë në ndihmë. Ata janë në gjendje të mirë dhe nuk janë të rrezikuar", thuhet në komunikatën e MPJD-së.

Kjo ministri, po ashtu, ka vënë në

gatshëm ta garantojmë sigurinë dhe mirëqenien e tyre", ka shkruar Xhaçka.

"Zëri i Amerikës" raporton se grupi i parë prej 250 afganësh, pritet të arrijë në Shqipëri brenda kësaj jave. Burimet diplomatike i kanë thënë Zërit të Amerikës se bëhet fjalë për përkthyes dhe bashkëpunëtorë të niveleve të ndryshme të strukturave amerikane në Afganistan. Ata do të transferohen së bashku me familjet e tyre.

Të dielën, më 15 gusht, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, konfirmoi se ditët e fundit, Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka kërkuar nga Shqipëria që të shërbejë si vend transit për emigrantët politikë afganë. "Pa diskutim që ne nuk do të themi jo, jo thjesht që na kërkojnë aleatët tanë të mëdhenj, po sepse ne jemi Shqipëria", ka shkruar kryeministri Rama në "Facebook". Ndërkohë, bëhet me dije se zyrtarisht nuk është asnjë shtetas shqiptar në Afganistan, përfshirë edhe forcat e armatosura të

ushtrore të Shqipërisë që ishin pjesë e misionit paqeruajtës, të cilat janë kthyer në Shqipëri pak muaj më parë.

Maqedonia e Veriut, po ashtu, u është përgjigjur pozitivisht thirrjeve të autoriteteve amerikane për strehimin e qytetarëve afganë.

Bujar Osmani, ministër i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, ka deklaruar për "Radio Evropë e Lirë" se autoritetet po bëjnë përgatitje për strehimin e afganëve. "Qeveria në komunikim me partnerët amerikanë dhe të NATO-s ka ofruar të strehojë civilët afganë të cilët ikin nga zhvillimet atje dhe po bëjmë të gjitha përgatitjet e nevojshme për pranimin e tyre", tha Osmani.

Talebanët kanë pretenduar fitoren në Afganistan më 15 gusht, pasi kanë marrë kontrollin e kryeqytetit, Kabulit, pas gati 20 vjetëve të dhënies fund të pranisë ushtarake të forcave të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara.



dispozicion numrin kontaktues: +383 45 492 316, ku të gjithë qytetarët e Kosovës mund të thërrasin për t'i marrë udhëzimet dhe ndihmën e nevojshme.

Shqipëria tregon gatishmëri për strehim të qindra afganëve

Shqipëria është e gatshme të strehojë qindra qytetarë afganë të cilët po largohen nga Afganistani, duke u bërë pjesë e listës së dhjetëra shteteve që janë zotuar të pranojnë afganët që kërkojnë të arratisen nga vendi pas krizës së krijuar. Ministria e Punëve të Jashtme, Olta Xhaçka, përmes një postimi në "Twitter", më 16 gusht, bëri me dije se Shqipëria është e gatshme të strehojë qindra afganë dhe ta sigurojë mirëqenien e tyre. "Shqipëria është gati të presë qindra afganë jetët e të cilëve janë të kërcënuara nga situata e sigurisë në përkeqësim. Në qëndrojmë krah aleatëve tanë, të

ShBA-ja lavdëron Kosovën dhe Shqipërinë

Zyrtarë të Shteteve të Bashkuara kanë mirëpritur vendimin e Kosovës dhe të Shqipërisë që t'u strehojnë përkohësisht afganët që bashkëpunuan me forcat amerikane, teksa talebanët kanë marrë nën kontroll pothuajse tërë territorin e Afganistanit. Departamenti amerikan i Shtetit tha se Kosova u është bashkuar thirrjeve për largimin e sigurt të njerëzve nga Afganistani.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Yuri Kim, ka reaguar në lidhje me gatishmërinë e Shqipërisë për t'i strehuar refugjatët afganë. "Besa - kur ka më shumë rëndësi - populli shqiptar tregon gjithmonë nder, guxim dhe mirësi. Ne jemi krenarë t'ju quajmë mikun dhe aleatin tonë", ka shkruar

ambasadorja në "Twitter".

Ish-sekretarja amerikane e Shtetit, Madeleine Albright, ka përgëzuar Kosovën, Shqipërinë, por edhe Maqedoninë e Veriut për gatishmërinë e tyre për t'i strehuar afganët, jeta e të cilëve rrezikohet nga talebanët. Ajo ka shprehur mirënjohjen e saj, duke thënë që shpreson që këtë shembull do ta ndjekin edhe vendet e tjera.

Komiteti për Marrëdhënie me Jashtë i Senatit amerikan ka shkruar se mirëpret vendimin e Qeverisë së Shqipërisë që t'i strehojë afganët. "Populli i Shqipërisë edhe një herë i ka treguar botës se çfarë nënkupton besa. Ju keni respektin dhe falënderimin tonë", thuhet në një postim në "Twitter" të këtij komiteti.



Dy të vdekur nga Covidi dhe 740 raste pozitive në 24 orët e fundit

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, nga 5 646 testime, 740 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. MS-ja ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar edhe dy raste të vdekjes

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 GUSHT - Të hënën në Kosovë janë regjistruar dy raste të vdekjes nga Covid-19. Viktimat janë, njëri nga Peja, tjetri nga Klina. Sipas njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë, janë regjistruar edhe 740 persona të infektuar me Covid-19. Shifrat janë publikuar pas testimit të 5 646 mostrave. Më së shumti të infektuar janë shënuar në Prishtinë, gjithsej 187. Sipas raportit ditor, më së shumti raste janë shënuar në grupmoshën 20-29 vjeç, përkatësisht 193 raste. Sipas njoftimit të MSh-së, në 24-orëshin paraprak janë shëruar edhe 48 pacientë, ndërsa raste aktive janë 8

544.

Që prej 13 marsit të vitit 2020 deri më 16 gusht 2021 Kosova ka regjistruar gjithsej 116 247 raste me Covid-19, 2 284 viktima, ndërsa 1106 109 pacientë janë shëruar.

Më herët Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ka njoftuar se janë 380 pacientë të shtrirë në klinikat Covid dhe spitalet e përgjithshme. Sipas njoftimit, 316 prej tyre janë konfirmuar pozitivë me Covid-19.

Autoritetet shëndetësore kanë bërë me dije se 17 pacientë janë në gjendje të rëndë shëndetësore, ndërsa 278 po trajtohen me oksigjeno-terapi.

Pulmologu Besim Morina e ka vlerësuar shumë shqetësues



trendin e rritjes së infektimit me Covid-19. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shpejtësia e infektimit për një kohë kaq të shkurtër tregon se institucionet

duhet të përgatiten për një skenar të rrezikshëm të pandemisë. Morina ka bërë me dije se vaksinimi është mënyra më e lehtë dhe më e sigurt e parandalimit të

sëmundjes dhe vdekjes nga Covid-19. Ai ka theksuar se puna e punëtorëve në shëndetësi, arsim dhe në administratë është dashur të kushtëzohet me vaksinim.

Aktakuzë ndaj katër personave për tregti të ndaluar dhe shpëlarje të parave

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Special kundër katër të pandehurve me inicialet A. B., V. M., A. A., A. T. Prokuroria Speciale ka njoftuar se të pandehurit me inicialet A.

B., V. M., A. A., A. T., dyshohet se kanë kryer veprën penale "Tregtia e ndaluar" nga neni 305, paragrafi 1 i Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës. "Po ashtu, katër të pandehurit me inicialet A. B., V. M., A. A., A. T. dyshohet se kanë kryer edhe veprën penale 'Shpëlarja e par-

ave', nga neni 302 i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 56, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit", ka njoftuar Prokuroria Speciale e Kosovës.



Krasniqi: Austria vazhdon ta mbështesë Kosovën

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka takuar ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger, me të cilin kanë diskutuar për miqësinë historike të dy popujve tanë si dhe për përkrahjen dhe për fuqizimin e shtetit të Kosovës. Krasniqi ka shkruar në

llogarinë e vet në "Facebook", se Austria vazhdon ta mbështesë Kosovën në të gjitha fushat e zhvillimit dhe në rrugën e integritetit euroatlantike. "Po ashtu, u dakorduam se bashkëpunimi ynë edhe mund të thellohet dhe të begatohet me përmbytje të reja, me interes të ndërsjellë", ka shkruar ai.

Rama: Nga 1 gushti rreth 860 mijë turistë e vizituan Shqipërinë

Tiranë, 16 gusht (ER) - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka njoftuar të hënën se nga 1 gushti këtë vend e kanë

vizituar rreth 860 mijë shtetas të huaj. Sipas tij, kjo është 4.5 për qind më shumë sesa periudha e njëjtë e vitit 2019. "Lajme të mira

për Shqipërinë destinacion turistik. Nga data 1-15 gusht kanë hyrë 859 316 shtetas të huaj, që janë 4.5 për qind më shumë

se e njëjta periudhë e 2019-s, domethënë para pandemisë", ka shkruar Rama në llogarinë e vet në "Facebook".





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA PRANUAR APLIKIMET E SUBJEKTEVE POLITIKE PËR ZGJEDHJET LOKALE TË 17 TETORIT

Partitë politike dorëzojnë listat e kandidatëve për zgjedhjet lokale

Subjektet politike kanë dorëzuar të hënën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) listat e kandidatëve për kryetarë të komunave dhe kandidatëve për asamble komunale. Listat e partive të mëdha nuk kanë sjellë ndonjë befasi, duke zyrtarizuar kandidatët që janë pritur. Edhe këtë herë është vërejtur numër i vogël i kandidateve në garën për kryetarë të komunave. Përfaqësuesit e partive më të mëdha politike kanë shprehur optimizëm për rezultatin e zgjedhjeve të 17 tetorit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 GUSHT - Subjektet politike kanë dorëzuar të hënën për certifikim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) listat e kandidatëve për kryetarë të komunave dhe të kandidatëve për asamble komunale. Përfaqësuesit e partive më të mëdha politike kanë shprehur optimizëm për zgjedhjet e 17 tetorit. Edhe kësaj radhe është vërejtur numër i vogël i kandidateve në garën për kryetarë të komunave.

Pas dorëzimit të listës së kandidatëve për certifikim në KQZ, Sibel Halimi, kandidate e Lidhjes Demokratikë të

Kosovës për kryetare të Ferizajt, ka deklaruar se kjo parti në këto zgjedhje do të garojë me tri gra për kryetare. "LDK-ja ka zyrtarizuar të gjithë kandidatët për kryetarë në nivel komune. Për herë të parë kemi kandidate tri gra për kryetare. Ky është një lajm i mirë dhe kemi përfshirje të reja në listat e asamblistëve", ka deklaruar Halimi.

Kurse Xhafer Tahiri, kryetar i Vushtrrisë, që pretendon edhe një mandat, ka treguar se në Han të Elezit dhe Skenderaj kjo parti nuk do të garojë për kryetar komune, por vetëm për asamble.

Lista e kandidatëve të LDK-së për kryetarë të komunave është kjo: Lutfi Haziri, kandidat për kryetar të komunës së Gjilanit;

Anton Quni, kandidat për kryetar të komunës së Prizrenit; Ilir Ferati, kandidat për kryetar të komunës së Istogut; Hyrie Dobrunaj, kandidate për kryetare të komunës së Deçanit; Burim Krasniqi, kandidat për kryetar të komunës së Rahovecit; Besim Hoti, kandidat për kryetar të komunës së Klinës; Bajrush Hoti, kandidat për kryetar të komunës së Malishevës; Bexhet Xheladini, kandidat për kryetar të komunës së Dragashit; Jeton Biqkaj, kandidat për kryetar të komunës së Kamenicës; Ruzhdi Shehu, kandidat për kryetar të komunës së Junikut; Sibel Halimi, kandidate për kryetare të komunës së Ferizajt; Armend Agolli, kandidat për kryetar të

komunës së Mitrovicës; Teki Shala, kandidat për kryetar të komunës së Gjakovës; Mehmet Krasniqi, kandidat për kryetar të komunës së Obiliqit; Bedri Zeqiri, kandidat për kryetar të komunës së Shtimes; Anduena Gllareva, kandidate për kryetare të komunës së Drenasit; Shkëlqim Jakupi, kandidat për kryetar të komunës së Kaçanikut; Bajrush Ymeri, kandidat për kryetar të komunës së Novobërdës.

AAK-ja paraqet 21 kandidatët për kryetarë të komunave

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka shprehur optimizëm për rezultatin e zgjedhjeve të 17 tetorit. Në një konferencë për media, ku ka paraqitur 21 kandidatët e kësaj partie për kryetarë të komunave, Haradinaj ka thënë se, përveç gjashtë kryetarëve aktualë, kjo parti do të fitojë edhe në më shumë komuna pas 17 tetorit.

"Vlera e parë është njeriu. Kemi njerëzit e duhur në kohën e duhur për t'i qeverisur komunat. Janë 21 kandidatë deri më tani, duke filluar nga gjashtë që janë duke qeverisur dhe të dëshmuar dhe të vlerësuar lart nga qytetarët", ka thënë Haradinaj.

Ai ka theksuar se oferta e AAK-së është serioze dhe se kandidatët e saj kanë dëshmuar qeverisje efikase dhe të ndershme. "Secili nga ta e ka listën e kandidatëve të dëshmuar për në asamble. Vlera e dytë është oferta për zgjedhjet lokale. Janë programet qeverisëse të cilat janë hartuar prej njohësve të qeverisjes lokale dhe pastaj këto programe janë mishëruar me qytetarin. Si vlerë e tretë është mënyra e qeverisjes e cila është e efektshme. Kjo është oferta jonë dhe me këtë dëshmojmë seriozitetin", ka thënë Haradinaj.

Këta do të jenë kandidatët e AAK-së për kryetarë të komunave: Agron Gashi, kandidat për kryetar të komunës së Dragashit; Agron

Kuçi, kandidat për kryetar të komunës së Junikut; Arben Halili, kandidat për kryetar të komunës së Ferizajt; Ardian Gjini, kandidat për kryetar të komunës së Gjakovës; Arta Ahmeti-Xhylani, kandidate për kryetare të komunës së Drenasit; Ali Krasniqi, kandidat për kryetar të komunës së Obiliqit; Bali Muharremaj, kandidat për kryetar të komunës së Suharekës; Bashkim Budakova, kandidat për kryetar të komunës së Lipjanit; Bashkim Ramosaj, kandidat për kryetar të komunës së Deçanit; Bekë Berisha, kandidat për kryetar të komunës së Istogut; Besnik Tahiri, kandidat për kryetar të

komunës së Podujevës; Daut Haradinaj, kandidat për kryetar të komunës së Prishtinës; Faton Jakupi, kandidat për kryetar të komunës së Kamenicës; Hasan Ismajli, kandidat për kryetar të komunës së Fushë-Kosovës; Kastriot Berisha, kandidat për kryetar të komunës së Malishevës; Lulzim Kabashi, kandidat për kryetar të komunës së Prizrenit; Mensut Ademi, kandidat për kryetar të komunës së Vushtrrisë; Nazim Gagica, kandidat për kryetar të komunës së Gjilanit; Rustem Berisha, kandidat për kryetar të komunës së Pejës; Smajl Latifi, kandidat për kryetar të komunës së Rahovecit; Zenun Elezaj, kandidat për kryetar të komunës së Klinës.

PKD-ja ka publikuar emrat e shumicës së kandidatëve

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka paraqitur shumicën e kandidatëve të kësaj partie për kryetarë të komunave në zgjedhjet lokale. Edhe në listën e PDK-së figurojnë disa kandidate për pozitën e kryetares së komunave. Uran Ismaili do të jetë kandidat për kryetar të Prishtinës; Sami Lushtaku, kandidat për kryetar të Skenderaj; Shaqir Totaj, kandidat për kryetar të Prizrenit; Bedri Hamza, kandidat për kryetar të Mitrovicës; Ramiz Lladrovci, kandidat për kryetar të Drenasit; Sokol Bashota, kandidat

për kryetar të Klinës; Naim Ismajli, kandidat për kryetar të Shtimes; Astrit Ademaj, kandidat për kryetar të Pejës; Shaqir Hetemi, kandidat për kryetar të Leposaviqit; Fatos Shala, kandidat për kryetar të Junik; Hyzer Rizani, kandidat për kryetar të Lipjanit; Isni Kilaj, kandidat për kryetar të Malishevës; Floretë Zejnullahu, kandidate për kryetar të Podujevës; Ali Nimanaj, kandidat për kryetar të Istogut; Leonora Morina-Bunjaku, kandidate për kryetar të Gjilanit; Bekim Azizi, kandidat për kryetar të Vitisë; Ferit Idrizi, kandidat për kryetar të Vushtrrisë; Shaban Shabani, kandidat për kryetar të Dragashit; Hanefi Musliu, kandidat për

kryetar të Obiliqit; Bejtullah Deliu, kandidat për kryetar të Rahovecit; Muhamed Kallaba, kandidat për kryetar të Kamenicës; Besim Ilazi, kandidat për kryetar të Kaçanikut. Në zgjedhjet e 17 tetorit me më pak kandidatë për kryetarë të komunës do të marrin pjesë Nisma Socialdemokrate dhe AKR-ja. Por gara më interesante të këto dy parti është në Malishevë dhe Prishtinë. Nisma për kryetar të Malishevës ka kandiduar Ekrem Kastratin, kurse AKR-ja për kryetar të Prishtinës ka kandiduar Selim Pacollin. Lëvizja Vetëvendosje ende zyrtarisht nuk ka treguar për emrat e kandidatëve për kryetarë të komunave.

Mosakreditimi i Elektroenergjetikës rrezikon ta lë pa kuadro KEK-un



PRISHTINË, 16 GUSHT - Dega e studimeve në nivelin bachelor të Elektroenergjetikës në Universitetin e Prishtinës (UP) nuk është akredituar këtë vit. Nëse ky vendim nuk ndryshon pas ankesave, UP-ja do të mbesë pa akreditim në të gjitha nivelet e studimit në këtë degë. Kjo degë e studimeve konsiderohet me rëndësi të madhe pasi që prodhon kuadro që mund të punojnë në kompanitë e fushës së energjisë në vend, duke përfshirë Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) që punëson rreth 4 700 punëtorë në fusha të ndryshme të operimit. Agjencia e Akreditimit e

Kosovës, përkatësisht Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjet e mbajtura më 7 dhe 27 korrik ka marrë vendim lidhur me akreditimin e programeve të studimit nëpër të gjitha universitetet private dhe publike. Këto vendime KShC-ja i merr në bazë të raporteve të ekspertëve ndërkombëtarë të cilët vizitojnë universitetet dhe dalin me raport lidhur me përmbushjen e kriterëve të cilësisë. Në bazë të vendimit që Agjencia e Akreditimit ka publikuar, Dega e Elektroenergjetikës në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) nuk është akredituar për

vitin akademik 2021/22. Sipas këtij vendimi, në vlerësimin e ekspertëve është thënë se Dega e Elektroenergjetikës nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, i përmbush plotësisht dy kapituj, ndërsa pesë të tjerë i përmbush vetëm pjesërisht. Sipas raportit të ekspertëve, kapitujt që janë vlerësuar se janë të përmbushur pjesërisht janë: Misioni, objektivat dhe administrata; menaxhimi cilësor; përmbajtja e procesit arsimor; hulumtimet shkencore; infrastruktura dhe resurset. Ndërsa si të përmbushura mjaftueshëm janë cilësuar kriteri i studentëve

dhe stafit akademik. Për shkak të këtij vendimi, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike nuk ka hapur konkurs për studentë të rinj për këtë vit akademik. Megjithatë, dekani i këtij fakulteti, Isak Shabani, tha për "Radion Evropa e Lirë" se nuk janë të kënaqur me këtë vendim dhe do të ankohen. Agjencia e Akreditimit ka bërë me dije se universitetet "kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e KShC-së". Sipas këtij institucioni, fillimisht ankesa i drejtohet titullarit që e ka marrë vendimin, në këtë rast KShC-së, pastaj Komisionit të Ankesave dhe në fund ekziston mundësia

e ankimit në gjykatë. Dega e Elektroenergjetikës në Kosovë momentalisht nuk ka asnjë nivel të studimit të akredituar. Përveç nivelit bachelor që nuk u akreditua këtë vit, niveli Master ka tre vjet që nuk akreditohet në mungesë të tre profesorëve bartës të lëndës (doktor shkence). As dega e doktoraturës nuk është e akredituar. Sipas dekanit Shabani, kjo degë prodhon kuadro që janë shumë të nevojshme për industrinë në Kosovë. Edhe Korporata Energjetike e Kosovës që prodhon rrymën me dy termocentrale, e ka parë si shqetësuese këtë situatë.

Kandidati i LV-së për kryetar të Skenderajt tërhiqet nga gara, e mbështet Bekim Jasharin

SKENDERAJ, 16 GUSHT (ER) - Kandidati i nominuar nga Lëvizja Vetëvendosje për kryetar të Skenderajt, Hysni Mehani, ka hequr dorë nga gara për kryetar të Skenderajt. Ai në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se dalja e dy fotove të bacës Rifat, që në një formë nënkupton edhe mbështetje për kryetarin aktual Bekim Jashari, i ka vënë në një dimension tjetër. "Në vitin 2017 kemi garuar për ta përligjur procesin zgjedhor, tash, në vitin 2021, Lëvizja është subjekti më i madh në vend, e në Skenderaj bindshëm subjekti i dytë. Rrjedhimisht, kudo që garojmë, garojmë veç për të fituar. Fakti që nuk do të garojmë për kryetar, nuk

nënkupton në asnjë mënyrë që i kemi falur apo harruar ato që kemi kaluar gjatë mandatit katërvjeçar si asamblistë. Ta mundësh Bekim Jasharin nuk është kurrfarë e arriture. Ti kontribuosh mundjes së Bekim Jasharit për ta kthyer PDK-në në qeverisje lokale është gabim dhe dëm. Ta mundësh Bekimin e familjes Jashari është gabim i pafalshëm historik", ka shkruar Mehani. Ai ka bërë thirrje që të votohet lista e Lëvizjes Vetëvendosje për Kuvend Komunal. "Asamblistët e Lëvizjes nuk do ta shtyjnë Bekimin drejt veprimeve të gabuara, as nuk do ta përkrahin në veprime të gabuara. Këtë e kemi dëshmuar në katër vjetët që shkuan", ka thënë Mehani.



Nis faza e tretë e dezinfektimit hapësinor në Gjiçan

GJIÇAN, 16 GUSHT (ER) - Komuna e Gjiçanit, në bazë të kontratës me operatorin ekonomik dhe vlerësimin të komisionit komunal, në koordinim edhe me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka njoftuar se të martën në mbrëmje nis faza e tretë e dezinfektimit hapësinor. Drejtori i Shëndetësisë në Gjiçan, Selami Xhemaili, ka konfirmuar se

të gjitha përgatitjet janë bërë që faza e tretë e dezinfektimit të nisë në orën 19:30 deri në orën 24:00 dhe do të vazhdojë kështu për pesë ditë me radhë. "Apelohej te të gjithë qytetarët që t'i mbajnë dritaret e mbyllura, që mos të futen insektet brenda, sikurse një kujdes i veçantë duhet të kenë edhe bletarët të cilët rekomandohen t'i mbyllin bletët e

tyre nga ora 19:30 deri në orën 05:00, që të mos kenë ndonjë dëmtim eventual", ka thënë ai. Dezinfektimi do të bëhet në zonën urbane dhe në fshatra. Njëkohësisht Xhemaili ka thënë se janë duke u bërë përgatitjet edhe për dezinfektimin e shkollave dhe institucioneve edukative për të krijuar ambient të përshtatshëm për fillimin e mbarë të mësimin.

Ekrem Kastrati, kandidat i Nismës për kryetar të Malishevës

MALISHEVË, 16 GUSHT (ER) - Nisma Socialdemokrate ka bërë me dije se kandidat i saj për kryetar të komunës së Malishevës në zgjedhjet e 17 tetorit është Ekrem Kastrati i cili rrjedh nga një familje patriotike dhe bujare nga fshati Turjakë. Kastrati është një ndër celulat e para të UÇK-së në komunën e Malishevës. Ai ka qenë i burgosur politik dhe i dënua me dhjetë vjet burgim. Ka kaluar nëpër shumë burgje të Kosovës e të Serbisë, ndër to edhe në masakrën e burgut të Dubravës. Ekrem Kastrati me profesion është jurist, ndërsa pas luftës ka kryer shumë detyra menaxheriale, duke



filluar nga Posta dhe Telekom i Kosovës, në QKUK, pastaj sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe kryeinspektor i Inspektoratit të

Punës. Ekrem Kastrati ka kundërkandidatë për komunën e Malishevës Isni Kilajn e PDK-së dhe Alban Krasniqin e Lëvizjes Vetëvendosje.



Komuna e Prishtinës liron hapësirat publike në parkun e Taukbahçes

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Sektori i Rendit Komunal në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit ka zhvilluar të hënën një aksion për lirim të hapësirave publike në parkun e Taukbahçes në Prishtinë. Kryetari i komunës së

Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se janë larguar tarracat e shtatë lokaleve afariste që kanë uzurpuar pjesë të caktuara të parkut. Kryetari Ahmeti ka bërë me dije se aksione të tilla do të ketë edhe në lokacione të tjera të kryeqytetit.

Komuna e Podujevës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas

Podujevë, 16 gusht (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar të hënën marrëveshje bashkëpunimi me drejtoreshën e Agjencisë për Ndihmë Juridike, Anita Alaj-

Kalanderi. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është që Agjencia për Ndihmë Juridike t'i ofrojë shërbimet e saj edhe në komunën e Podujevës. Nga java e ardhshme do të fillojë të mbahet kampanjë dyjavore,

saktësisht sesione informuese për punën dhe veprimtarinë e agjencisë. Kjo zyrtë do të zhvendoset në një nga zyrat e ish-objektit të komunës. Kryetari Bulliqi ka thënë se ky

është një lajm i mirë për qytetarët e komunës së Podujevës, pasi tash e tutje do ta kenë një adresë ku mund të marrin shërbime juridike falas për t'i shfrytëzuar të drejtat e tyre.



Status quot janë të paqëndrueshme



Shkruan: Valon MURATI

Zhvillimet dramatike këto ditë në Afganistan, ato të paradokohshmet në Nagorni Karabah, mbi të gjitha ndryshimet gjeopolitike me forcimin e Kinës dhe rikthimin e Rusisë si aktor global, dëshmojnë një gjë: status quot janë të paqëndrueshme. Duke i lexuar drejt këto zhvillime, në rastin tonë duhet ta kuptojmë se

dalja nga një status quo në planin ndërkombëtar dhe të raporteve me Serbinë është e domosdoshme. Nuk ka rrugë tjetër në këtë drejtim veç të kuptuarit se duhet shfrytëzuar dialogun me Serbinë për t'i zgjidhur problemet e mbetura me të, përfshirë çështjen e Kosovës Lindore. Nuk duhet të frikësohemi nga dialogu, por

duhet ta shfrytëzojmë atë për të mirën e përgjithshme. Krahas dhe në funksion edhe të dialogut dhe pozicionit tonë duhet forcuar unitetin e brendshëm, funksionalizuar shtetin e Kosovës, sidomos duhet forcuar sundimin e ligjit, duhet rritur koordinimin me Tiranën dhe duhet punuar afër me aleatët tanë. Krejt këto ndryshime

gjeopolitike duhet të na bëjnë të vetëdijshëm që si hap të parë duhet konsoliduar shtetin e Kosovës. E si hap të dytë na duhet bashkimi (e jo përçarja) me Shqipërinë, jo vetëm si e drejtë historike por, mbi të gjitha, në funksion të rritjes së sigurisë dhe të zhvillimit ekonomik në një botë që po ndryshon.

Sami Lushtaku: PDK-ja është e fortë në Drenicë



SKENDERAJ, 16 GUSHT - Lëvizja Vetëvendosje ka mbetur pa kandidat për kryetar të Skenderajt. Hysen Mehani, të cilin e emëroi dega e këtij subjekti atje, u tërhoq nga gara dhe konfirmoi mbështetjen për kryetarin aktual të Skenderajt, njëherësh deri dje ish-

kundërkandidatin e tij, Bekim Jashari.

Kjo s'po e tremb fare rivalin e tyre nga radhët e PDK-së, Sami Lushtakun.

Ky i fundit, në një prononcim për "Front Online", i paralajmëroi të dy se do t'i mposhtë, madje goxha bindshëm në garën zgjedhore për

Skenderajn. "Ne jemi në garë. Frikë nuk kam as nuk kam pasur kurrë. PDK-ja është e fortë në Drenicë. Besojmë fuqishëm që i kemi 70 për qind të votave. Po presim fitore", ka thënë Lushtaku. Hysen Mehani i LV-së, për numrin një të PDK-së në Skenderaj, është i panjofshëm.

"Kush është ai?", pyet Lushtaku. Skenderaj ka qenë bastion i PDK-së që prej se në Kosovën e pasluftës janë organizuar zgjedhjet. Ramadan Gashi e udhëhoqi për gati tetë vjet, më vonë, pas pavarësisë, Sami Lushtaku.

Në zgjedhjet e kaluara lokale, ato

të 2017-s, subjekti nuk garoi fare në këtë komunë, pasi e mbështeti Bekim Jasharin.

Meqë tash për zgjedhjet lokale të këtij viti, që do të mbahen më 17 tetor, i kanë ndarë rugët, gara në Skenderaj në mes të Jasharit dhe Lushtakut pritet të jetë një nga më të nxehtat politike.

Policia zbaton planin operativ "Alkooli", konfiskon 216 patentshoferë

GJAKOVË, 16 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës, njësitet relevante të trafikut rrugor në rajonin e Gjakovës, prej muajit korrik deri më 15 gusht përmes task forcës ka implementuar planin operativ "Alkooli", me ç'rast, për shkak të përdorimit të alkoolit nga drejtuesit e automjeteve si masë mbrojtëse, janë konfiskuar: 216 patentshoferë, ndërsa është bërë matja e nivelit të përdorimit të alkoolit ndaj 1 382 vozitësve. Duke marrë

parasysh se çdo vit evidentohen aksidente fatale të shkaktuara nga vozitësit e dehur, qëllimi i planit ka qenë i fokusuar në këto pika: Ngritja e sigurisë rrugore; Vetëdijesimi i vozitësve që mos ta ngasin automjetin nën ndikimin e alkoolit; dhe masat e ndërmarra preventive përmes fushatave vetëdijesuese, mediave dhe masave ndëshkuese për shkelësit e ligjit. "Efekti i dëshiruar është arritur për shkak se prej kohës kur ka filluar implementimi i planit

operativ në rajon, nuk janë evidentuar aksidente me pasoja fatale dhe, po ashtu, vërehet vetëdijesim më madh i drejtuesve të mjeteve motorike. Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në DRP-Gjakovë do të vazhdojë marrjen e masave të ndryshme preventive dhe ndëshkuese, gjithmonë me qëllim të ngritjes së sigurisë rrugore dhe parandalimit të aksidenteve rrugore, sidomos ato me pasoja të rënda", ka njoftuar Policia e Kosovës.



OEK-u dhe platforma 'CiviKos', me rekomandime të përbashkëta për vaksinim masiv

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 GUSHT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, dhe drejtoresha ekzekutive e platformës "CiviKos", Donika Emini, kanë mbajtur të hënën një konferencë të përbashkët për media, në të cilën kanë shpalosur rekomandimet e tyre rreth zhvillimeve të fundit të përbashkëta me pandeminë dhe mundësinë për rritjen e shifrave të vaksinimit në Kosovë. Këto rekomandime janë përpiluar pas konsultimeve me përfaqësues biznesesh dhe partnerë nga shoqëria civile, të cilat janë bërë gjatë kohës që po zhvilloheshin aktivitetet e projektit "Rindërto më mirë".

Rukiqi e Emini kanë theksuar se rritja e numrit të të infektuarve dhe vaksinimi i ngadaltë kanë ngritur shqetësimet për mbyllje të re që do të rezultojë me situatë ekonomike të vështirësuar për sektorin privat dhe familjet që varen tërësisht nga të ardhurat e këtij sektori. Ndaj, në shenjë të adresimit të këtyre shqetësimeve dhe në shenjë kontributi në përpjekje për të menaxhuar dhe luftuar pandeminë, partnerët e projektit, gjegjësisht OEK dhe "CiviKos", kanë përmbledhur disa rekomandime të dala nga diskutimet e lartpërmendura: Heqja e burokracisë në rezervimin e terminëve për qasje më të lehtë e të thjeshtëuar të qytetarëve; Mundësimi i vaksinimit në qendrën më të

afërt, pa marrë parasysh vendbanimin e regjistruar zyrtarisht; Vaksinimi përmes ekipeve mobile nëpër biznese, pasi që aktiviteti i tyre ekonomik po pengohet nga oraret e limituara e ndërkohë rrezikshmëria nga kontakti me njerëz qenë të pavaksinuar rritet; Ekipet mobile të vaksinimit për vendet më rurale e të izoluar, e sidomos ato që banojnë kryesisht nga komunitetet e kanë përgjithësisht më pak qasje në informata të sakta; Riorganizim i resurseve të punëtorëve të shëndetësisë në atë mënyrë që oraret e vaksinimeve të vazhdojnë edhe në fundjavë. Kjo është sidomos e rëndësishme duke ditur që shumë qytetarë e kanë të pamundur të vaksinohen

gjatë ditëve të punës, aq më tepër nëse punojnë në qytete të tjera larg vendbanimit të tyre të regjistruar; Vaksinimi në sheshet e qendrave kryesore në vend për të arritur shifra që përkojnë me një vaksinim masiv të vendit; dhe bashkëpunimi me shtete të tjera për t'u siguruar që pasaporta jonë e vaksinimit do të pranohet si dëshmi nga ato shtete për t'i penguar pengesat eventuale në lëvizjen e lirë. Gjatë kësaj konference është konkluduar se është shumë e rëndësishme që të ketë kampanja të mirëmenduara dhe në bashkëpunim me hisedarë të ndryshëm, në mënyrë që të ketë një përpjekje më të madhe e më të përbashkët për t'i përçarur informatat e sakta te qytetarët

rreth të pavërtetave dhe miteve për vaksinimin, pasi vakcina është i vetmi mjet që kemi momentalisht kundër Covid-19. Përfaqësuesit e OEK-ut dhe të "CiviKos"-it kanë uruar që këto rekomandime të merren për bazë nga institucionet relevante në mënyrë që t'u ndihmohet në rikthimin në normalitet. Ata kanë theksuar se OEK-u dhe platforma "CiviKos" do të punojnë për komunikim të hapur dhe gatishmëri për bashkëpunim me bizneset, shoqërinë civile, institucionet qendrore dhe lokale, si dhe organizatat ndërkombëtare me gjithëpërfshirëse për t'i shtyrë përpara strategjitë e menaxhimit dhe luftimit sa më të efektshëm të pandemisë.



Zvicra, fuqinë punëtore më të aftë në botë

BERNË, 16 GUSHT - Në Raportin Botëror të Konkurrencës, i cili kryhet çdo vit nga Forumi Ekonomik Botëror, Zvicra ka befasuar me renditje, duke e dalë e pesta në renditjen e përgjithshme, por kryeson për aftësitë e forcës punëtore. Shteti ishte i renditur si më i miri për sa i përket trajnimit profesional, trajnimit në vendin e punës dhe punësimin e të diplomuarve të saj. Më shumë se 70 për qind e nxënësve të shkollave të mesme në Zvicër marrin pjesë në atë që quhet Sistemi i Trajnimit Profesional. Që nga moshë 16-vjeçare shumica e të rinjve e ndalojnë edukimin e

tyre me kohë të plotë, duke shikuar për të tjera mundësi si kurse të reja shkollore, trajnime në kompani të ndryshme ose fillimin e një pune të mirëfilltë në të cilën paguhen dhe paraqiten në punë. Raporti tregon se sistemi i ngritur nga Zvicra, në të cilën marrin pjesë 30 për qind e kompanive, përgatit një seksion të gjerë të studentëve për karrierë duke i ndarë në profesione dhe sektorë të ndryshëm. "Ky sistem gëzon një mbështetje shumë të madhe nga punëdhënësit zvicëranë, të cilët e cilësojnë një kontribut të madh në

vitalitetin dhe fuqinë ekonomike të Zvicrës", thuhet në raport. Shteti i Zvicrës përfiton nga një linjë e gjatë profesionistësh të rinj dhe të talentuar, papunësi e ulët ndërmjet të rinjve dhe një forcë punëtore me plot aftësi e cila si rezultat prodhon të mira dhe shërbime në cilësi të lartë. Me fokusin te trajnimet dhe shkollat profesionale, zbehet dëshira e të rinjve për të marrë një diplomë universiteti. Më pak se një e treta e të rinjve nën moshën 25 vjeç shkuan drejt edukimit të lartë në vitin 2012, krahasuar me më shumë se gjysmën në vende të tjera si Australia dhe Norvegjia.





ESAD MEKULI

VDEKJA E DITËS

Dielli n'perëndim
N'zjarrin flakruet
U dogj...
Dhe çdo gja u trand,
u pikllue
n'vaj për të.
N'arkivolin e heshtjeve t'muzgut,
n'dhimbje bonjake
sonte,
i dashtuni, i yni,
me lot t'pastër
u vajtue:
Psherëtima e gjethit t'barit
dhe d'nesa e prajshme e erës
me pikllim zemrën e poq...
Dielli sonte
n'zjarrin flakruet
u dogj.

NË MËNGJES

Horizonte zbulue me bardhsi mëngjesore
zgjohen...
Dy-tri përvidhen hapsirë,
udhëtojnë,
t'bardha e t'holla
si çarçafë t'lëshuem n'erë...
Fushat pëshpërisin lutje mëngjesore.
Ditën e re përshëndesin
Me lojë kunorash -
Drujt e gjethuem;
në bar kanga e gjallesave t'imta
ende himnin e saj...
Livadhe dhe arave t'vesueme,
zane... Dita po gdhin.
Fushat erënjoma shtrihen
Si trup i gufuem femne...
Endem, si fëmi, n'qetësinë mëngjesore
dhe trupin e ushqej me freski
t'barishtave dhe t'erës;
përkdhel mëngjesin me sy t'mbyllun
dhe thellë n'zemër qetoj,
me harresë mësheh, mbuloj
dhimbjet e shpirtit t'varruem.

RINISË

Zemrat i mbush me bukurinë e përjetshme t'lumnisë,
me harresë t'këndshme vuetjet i mbulon...
Hap rrugët e reja – në ditët e territ e t'zisë –
me ravat e thella t'gëzimit rrëgallat e jetës lavron.
Nëpër shtigje t'reja rrugë shpëtimi i çel,

me ato fuqi që ti njeh për bukuri:
çdo ar'e plleshme nga ti asht mbjellë,
prej kah do t'mbijë fara e re me t'reja brezni.
Fuqia jote jeton me shekuj e rritet gjithmonë,
kthjellohet, gufon, vlon – ky burim gëzimi
i jetës së re! – O, e dashura rinia jonë!...
- n'orët e shekujve ndëgjoj at'far' kumbimi.
Gërshetohet kënga e përhershme mbi t'madhnueshmen rini
–Ty, që ke le bashkë me këtë jetë!
- O, ti gëzim i vetëm i jetës, o ti lavdi,
para lumnisë sate fort n'habi kam mbetë!

Vaj! Me u kapë n'vallen e reve nkuqlime
Zemra me t'dhanun do t'më dëshironte
Që rinija t'gërthet i herë mâ me gëzime
Dhe mall i zemrës s'vuajtun t'gufonte.
-Por, pse zemra tingëllon përmallshëm
si za drithërim
dhe droja kaplon thellë zemrën e shpirtin tim?!
Kur dëshiroj aq rëtë mbi qytet me i soditë,
Derisa malli për t'pambërrijtshmen, m'kap, m'shafit.

ANDRRA E VAJZËS

Shushuritja e leht' e t'panjohtunit më treti fare
dhe agime t'kaltërta androva...

E nëpër kunor lakmish për 'limtare-
si lulja q'i jep qiellit lulzimin,
rinin ja dhurova.
Shkëlqyen yjet e qiellit si syt e tijë
të thellë dhe të ndritshm
dhe u shafit nën te e kërtneza fuqi...

-Sonte shushurutja e leht'e t'panjohtunit
më treti fare
dhe agimet e kaltërta androva

MALLI PËR T'PAMBËRRIJTSHËMEN

Retë luejnë n'naltësin, si qingjat n'kodrina,
Ndërsa malli për t'pambërrijtshmen ndryhet n'mue:
Dëshirojsha mu kapë n'vallen e reve kuqle
E me fluture në t'shkëqyeshmet naltësina
Me gëzimin e këngës baritore...
E kur hana e luginave ia beh n'shpejti
Dhe toka natën ndishrim thërret,
Si rrezet e argjendta mbi kalli-
Të shkoj
E t'vizitoj
Skajet e dhimbjes e vendet ku pashë ankthet.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82**

Prishtina konfirmon ndarjen edhe me pesë futbollistë

Pas Pefqelit, Gavazajt, Muçës, nga Prishtina zyrtarisht janë larguar edhe Maliqi, Muçiçi, Mankenda, Shillova dhe Bardhoku. Klubi "bardhekaltër" ka falënderuar futbollistët në fjalë për profesionalizmin, sjelljen korrekte, sakrificën dhe kontributin e dhënë për ngjyrat e klubit ndër vite

"Epoka e re"

PRISHTINË, 16 GUSHT - Kampionia e Kosovës në futboll, FC Prishtina, ka njoftuar të hënën se nga ky klub janë larguar edhe pesë futbollistë. Bëhet fjalë për Behar Maliqin, Alban Muçiçin, Gauthier Mankendan, Tun Bardhokun dhe Alban Shillovën. Klubi kryeqytetas ka falënderuar futbollistët në fjalë për kontributin e dhënë ndër vite për ngjyrat "bardhekaltër". "Klubi i Futbollit Prishtina falënderon futbollistët Behar Maliqi, Alban Muçiçi, Gauthier Mankenda, Tun Bardhoku dhe Alban

Shillova për profesionalizmin, sjelljen korrekte, sakrificën dhe kontributin e dhënë për ngjyrat e klubit tonë ndër vite. Futbollistët në fjalë dhanë kontribut të pashoq për ta nderuar fanellën bardhë e kaltër, me theks të veçantë në rikthimin e titullit kampion pas tetë vjetëve në kryeqytet. Kontingjentit të futbollistëve si Pefqeli, Gavazaj, Muça, Maliqi, Muçiçi, Mankenda, Shillova dhe Bardhoku, të cilët me skadimin e kontratave me FC Prishtina kanë zgjedhur destinacione të tjera në karrierë si brenda dhe jashtë vendit, Klubi i Futbollit Prishtina u dëshiron shumë fat dhe



suksese të mëtutjeshme", thuhet në njoftimin e skuadrës së Prishtinës.

Pas largimit nga Prishtina ka reaguar në "Facebook", Gauthier Mankenda, i cili pas katër edicionesh largohet nga skuadra kampiona e Kosovës. Ai ka

konsideruar se ishte privilegj t'i bartë ngjyrat e këtij klubi, derisa ka falënderuar të gjithë atë me të cilët ka punuar, në veçanti tifozët "Plisat". "Ishte privilegj të bartja ngjyrat bardhë e kaltër dhe kujtimet që kam pasur këtu do t'i kujtoj gjithmonë. Faleminderit

shokëve të skuadrës, trajnerit, shtabit teknik dhe menaxhmentit! Për të gjithë fansat dhe 'Plisat', dijeni se do të jem gjithmonë mirënjohës për dashurinë tuaj dhe mbështetjen e palodhur. I uroj klubit gjithë të mirat", ka shkruar Mankenda.

Taulant Hodaj zëvendëson Eroll Salihun në FFK



PRISHTINË, 16 GUSHT - Taulant Hodaj është emëruar ushtrues i detyrës i sekretarit të përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës. Lajmi është bërë me dije nga FFK-ja. Hodaj në këtë pozitë e zëvendëson Eroll Salihun, i cili javë me parë ka dhënë dorëheqje nga pozita e sekretarit të përgjithshëm, kurse është emëruar drejtor për çështje sportive dhe këshilltar senior ligjor. "Presidenti Agim

Ademi në bazë të kompetencave të tij e ka emëruar sot Taulant Hodajn, ushtrues detyre i sekretarit të përgjithshëm të FFK-së. Hodaj ka qenë udhëheqës i zyrës ligjore të FFK-së, si dhe avokat i cili e ka përfaqësuar FFK-në në arenën ndërkombëtare dhe në atë vendore, teksa tash do të jetë edhe u. d. sekretar i përgjithshëm", thuhet në njoftimin e FFK-së.

"Tifozët Kuq e Zi" sulmojnë me ngjyrë të kuqe Bashkinë e Korçës, shkak Bregoviçi

Korçë, 16 gusht - Tifozët e Kombëtares së Shqipërisë, "Tifozët Kuq e Zi", kanë ndërmarrë një aksion duke shprehur pakënaqësinë ndaj Bashkisë së Korçës, e cila e ka ftuar këngëtarin serb Goran Bregoviq në Festën e Birrës. Ata sulmuan me ngjyrë të kuqe zyrat e Bashkisë së Korçës, në shenjë revolte ndaj ftesës që i është bërë Bregoviqit. Ata thanë se ky ishte vetëm një paralajmërim dhe nuk do të ndalen derisa Bashkia e Korçës ta tërheqë ftesën për Goran Bregoviqin. "Sot kemi ndërmarrë një aksion simbolik para zyrave të Bashkisë Korçë. Ky ishte edhe një paralajmërim për organizatorët e festivalit të birrës që ta tërheqin ftesën për Goran




Bregoviqin. Ne nuk do të qëllimit", thuhej në postimin e ndalemi derisa t'ia arrijmë tyre.

Khaka vazhdon kontratën me Arsenalin

LONDËR, 16 GUSHT - "Football.london" raporton se Granit Khaka ka nënshkruar një kontratë të re me Arsenalin. Marrëveshja e re e mesfushorit shqiptaro-zviceran do ta lidhë atë me "Topçinjtë" deri në vitin 2025. Për këtë marrëveshje u japtuan

palët, pasi ra poshtë shitja e tij te Roma. Trajneri Jose Mourinho e kërkoi me ngulm mesfushorin, por kërkesa financiare e Arsenalit ishte e papërbalueshme për verdhekuqtë e Serisë A. Në fund kapiteni i kombëtares helvete pranoi rinovimin në

"Emirates", ku mori garancinë e trajnerit Arteta për aktivizim të rregullt. Sezoni i ri në Premierë Ligë nis shumë keq për "Topçinjtë", të cilët u turpëruan 2-0 nga debutuesit e Brentfordit, që kthehet pas 74 vjetësh në elitën e futbollit anglez.



PSG-ja i ofron rrogë marramendëse Pogbas

PARIS, 16 GUSHT - Mesfushori Paul Pogba mund të luajë me Paris Saint Germanin sezonin e ardhshëm. Kontrata e mesfushorit francez me Manchester Unitedin skadon në fund të këtij sezoni dhe ai nuk

do ta rinovojë atë, duke u larguar me koston zero. Sipas së përditshmes britanike "The Independent", skuadra e PSG-së kërkon të sjellë 28-vjeçarin në vendlindje, duke i ofruar një rrogë marramendëse: 600 mijë

sterlina në javë. Kjo shumë e çmendur pritet ta bindë francezin të luajë me PSG-në në krah të Mbappes, Messit, Donnarummas, Neymarit, Ramosit e mjaft yjeve të tjerë. PSG ka nisur që tani kontaktet

me menaxherin e Pogbas, Mino Raiola, për të diskutuar për të ardhmen. Për Paul Pogba është interesuar edhe Real Madridi, një mesfushor i talentuar që transferohet me koston zero verën e ardhshme.



Përfundon afati kalimtar, ja të gjitha transferimet në Superligë

Prishtinë, 16 gusht - Afati kalimtar i verës për futbollistë në Superligën e Kosovës në futboll është mbyllur, kurse klubet kanë bërë mjaft transferime për edicionin e ri 2021/22. Skuadrat pretendente për titull kanë qenë më aktive, duke u përforcuar për edicionin e ri që pritet të jetë mjaft i nxehtë. KF Malisheva është skuadra që ka sjellë futbollistë më së shumti në këtë merkato, gjithsejtë 14. Kampionia në fuqi e Kosovës, FC Prishtina, ka mbajtur një pjesë të lojtarëve kryesorë, teksa ka bërë 10 transferime. Ndërsa Feronikeli është e vetmja skuadër që nuk ka mundur të sjellë asnjë futbollist, pasi i është bllokuar merkato nga FIFA, shkak i mospagesës ndaj futbollistit shqiptar Bedri Grecës.

PRISHTINA

Xhevdet Shabani, Mendurim Hoti, Bleart Tolaj, Kristian Vangjeli, Florent Avdyli, Arlind Shabani, Betim Halimi, Olti Mehmeti, Sodiq Ololande Atanda, Benet Ismaili.

DRITA

Ardit Tahiri, Tun Bardhoku, Ron Broja, Agim Zeka, Almir Kryeziu, Prince Balde, Marko Simonovski, Muharrem Jashari, Arbnor Muja, Perparim Islami.

BALLKANI

Astrit Thaqi, Rustem Hoxha,



Theophilus Solomon, Malsor Ajeti, Albion Rrahmani, Stivi Frasheri.

GJILANI

Arion Ymeri, Arber Prekazi, Yll Hoxha, Fabjan Beqja, Albert Dabiqaj, Agustin Torassa, Elton Cale, Blerim Krasniqi, Ukshin Hoti.

LLAPI: Ilir Avdyli, Bianor Neto, Dardan Jashari, Francisco Rivera, Festim Alidema, Adem Maliqi, Dren Ahmeti, Alban Shillova, Alef Firmino, Drilon Fazliu.

DRENICA

Visar Haxhijaj, Erdin Dushi, Alvin Maccornel, Qlirim Avdull, Arbios Thaqi, Fatlum Gashi, Armend Abazi, Erjon Morina, Samuel Nii Noye Narh, Bruno Arrabal Passamani, Jeon Sushin.

DUKAGJINI

Arbër Shala, Argjend Bardhi, Henry Chibueze, Ergyn Ahmeti, Moriba Lamah, Ardin Dallku, Ermal Vitija, Ahmed Januzi, Bujar Shabani, Kenan Haxhihamza, Jozef Kuqi, Jean Carioca.

MALISHEVA

Abit Salihu, Agon Xhaka, Agron Bruqi, Mergim Pefqeli, Muhamet Hyseni, Gentrit Ulluri, Gentijan Binishi, Marc Oliver, Ronald Obëek, Hasan Hyseni, Fatlum Lleshi, Edison Mazreku, Torivoll Stullqaku, Ilir Mustafa.

ULPIANA

Marclei Santos, Iran Junior, Silvester Shkalla, Ermir Rezi, Denis Haliti, Leuart Avdyli, Jetmir Basha, Drilon Ajeti, Fabrice Boudega, Ardi Shala, Argjent Mustafa, Eglantin Hoxha.

Federeri do të operohet në gju

CYRIH, 16 GUSHT - Tenisti Roger Federer ka njoftuar se do t'i nënshtrohet një operacioni në gju, duke i dhënë fund sezonit të tij. Lajmin e ka dhënë ylli zviceran në mediat sociale. 40-vjeçari nuk ka garuar që kur u mund nga Hubert Hurkacz në çerekfinalen e Wimbledonit dhe duket se nuk do të kthehet në fushën e tenisit deri në vitin 2022, shkruan "Marca". Pyetjet në lidhje me gjendjen e tij ishin ngritur javët e fundit, veçanërisht pasi ai njoftoi se nuk do të garonte së pari në Lojërat Olimpikë dhe më pas në US Open. Në një video në



"Instagram", Federeri informoi fansat për vendimin e tij dhe pasojat e tij, ndërsa shikoi edhe përpara drejt së ardhmes. "Për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, mjekët më thanë nëse dëshiroja të ndihesha më mirë, do të më duhej një operacion, kështu që vendosa ta bëj. Unë do të jem me paterica për shumë javë dhe pastaj jashtë lojës për shumë muaj", ka thënë Federer. "Unë dua t'i jap vetes një shkëlqim shprese për t'u kthyer në turne në një formë apo formë tjetër", ka shtuar Federer, i cili ka falënderuar fansat e tij për mesazhet e tyre të mbështetjes dhe ka premtuar se do të japë përditësime të tjera së shpejti.

SHKURT

Kane nuk shkon te City

Tottenham Hotspur arriti të marrë një fitore të madhe 1-0 në javën e parë të Premierë Ligës kundër Manchester Cityt duke u hakmarrë në një farë mënyrë për të gjithë pakënaqësitë që i ka sjellë tentimi i "qytetarëve" për transferimin e Harry Kane. Por, si duket, klubi ia ka dalë ta bindë sulmuesin të qëndroje teksa trajneri Nuno Santos e ka përfshirë Kanen në listën e lojtarëve që do të udhëtojnë drejt Portugalisë për ndeshjen që Tottenhami do të luajë të enjten kundër skuadrës portugeze të Ferreriras.

Koeman: Është gjithmonë mirë kur e nis sezonin me fitore

Barcelona e nisi sezonin e ri në La Liga me një fitore bindëse 4-2 ndaj Real Sociedadit, ndërsa trajneri Ronald Koeman nuk e fshehu kënaqësinë për paraqitjen e skuadrës së tij. "Është gjithmonë mirë kur e nis sezonin me një fitore, pasi të shërben për moralin dhe mënyrën si do të përballosh ndeshjet e ardhshme. Ishte shumë e rëndësishme të tregonim një imazh të mirë dhe ia dolëm, duke fituar e duke luajtur mirë. Patëm pak minuta vështirësi me dy golat e Sociedadit sepse, pas golit të parë, erdhi ajo goditje dënimi e përkryer, të cilën vetëm mund ta duartrokisje, por reagimi i skuadrës ishte mjaft i mirë dhe morëm një fitore të merituar", ka thënë Koeman.

Liverpooli interesohet për Mbappen

Kylian Mbappe me të gjitha gjasat nuk do të jetë vitin e ardhshëm te PSG-ja. Parisienët kanë në plan të marrin edhe Cristiano Ronaldon, teksa konkurrenca e madhe me ardhjen e Leo Messit mund ta lërë francezin në hije. Liverpooli është futur në garë për t'i siguruar shërbimet e 22-vjeçarit. Plan i "The Reds" është për ta marrë sulmuesin verën e ardhshme falas. Real Madridi ndërkohë e kërkon me ngulm Mbappen, por duket se dhe këtë sezon ai do të jetë në Paris.

Courtois rinovon me Realin deri në vitin 2026

Real Madridi ka njoftuar se portieri Thibaut Courtois e ka zgatur kontratën. Gardiani belg zyrtarisht ka rinovuar kontratën me "Los Blancos" që do ta mbajë atë në "Santiago Bernabeu" deri në vitin 2026. Pas paraqitjeve të mira, skuadra madrilene vendosi ta shpërblejë 29-vjeçarin me rinovim të kontratës.

Interi kërkon nga Napoli të kërkojë uljen e çmimit të Insignes

Interi vazhdon të jetë në garë për Lorenzo Insignen, mirëpo dëshiron zbritjen e çmimit të cilin e kërkon Napoli, raporton "Sky Sport Italia". Kapiteni i Partenopei ka kontratë deri në verën e vitit 2022 dhe

rinovimi ka ngecur, pasi ai dëshiron rritje të pagës, ndërkohë që klubi i ka ofruar rrogë më të vogël se ajo që merr tani. Disa klube kërkojnë shërbimet e futbollistit italian, ndërsa Interi është shumë i

interesuar. Megjithatë, Napoli kërkon rreth 25-30 milionë euro për shërbimet e tij dhe "Nerazzurrët" konsiderojnë se është shumë për një 30-vjeçar. Për këtë arsye, zikaltrit duan të negociojnë një

shumë prej 20 milionë eurosh ose më të vogël për Insignen. Në ndërkohë, Interi vazhdon negociatat edhe me Lazion për Joaquin Correa, çmimi i të cilit është rreth 35-40 milionë euro.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIMIT
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 932/1
 Dt: 16.08.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHAPLLJE KONKURSI

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Malishevë për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Malishevë	Një (1) mësimdhënës/e për profilin Dizajn i tekstit dhe veshjeve (20 orë mësimore);	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës /e për profilin Instalues i ujësjellësi e kanalizim dhe ngrohje e klimatizim, (15 orë mësimore);	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjisllacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Malishevë. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës. Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Elkon" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për ndërtimin e minihidrocentralit tipit Digë (pa tubë derivacioni) Elez Hani 1 , Komuna e Elez Hanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.09.2021 në ora 09:00 në sallën e Komunes së Hanit te Elezit do të organizohet debat publik nga Kompania "Elkon" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për ndërtimin e minihidrocentralit tipit Digë (pa tubë derivacioni) Elez Hani 1 , Komuna e Elez Hanit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/8859249581?pwd=eGVTSzZlcUw5LdGdSdHVzQUUtdz09>

Meeting ID: 885 924 9581

Passcode: 4WgEW3

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Elkon" Sh.p.k. Prishtinë për Pëlqim Mjedisor, për ndërtimin e minihidrocentralit tipit Digë (pa tubë derivacioni) Elez Hani 1 , Komuna e Elez Hanit.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Elkon" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për ndërtimin e minihidrocentralit tipit Digë (pa tubë derivacioni) Elez Hani 2 , Komuna e Elez Hanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.09.2021 në ora 10:00 në sallën e Komunes së Hanit te Elezit do të organizohet debat publik nga Kompania "Elkon" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për ndërtimin e minihidrocentralit tipit Digë (pa tubë derivacioni) Elez Hani 2 , Komuna e Elez Hanit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/8859249581?pwd=eGVTSzZlcUw5LdGdSdHVzQUUtdz09>


Meeting ID: 885 924 9581

Passcode: 4WgEW3

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Elkon" Sh.p.k. Prishtinë për Pëlqim Mjedisor, për ndërtimin e minihidrocentralit tipit Digë (pa tubë derivacioni) Elez Hani 2 , Komuna e Elez Hanit.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Xhelal Kursani Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH. M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Florian Krasniqi Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. II. Të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Alma Mati Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Mimoza Dreni Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U. "Dëshmorët Lleshi" nga kl. VI-IX Doblbare Gjakovë.

► Ismail Mejzini Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Agron Bezhi Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH. M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Alma Morina Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X. XI të shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Manuel Domgjoni Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën nga kl. 6-9 e SH.F.M.U. "Anton Çeta" dol KK. Gjakovë.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studente ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa

mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



cilësi e garantuar

pa konservues